

Statut i Shoqërisë

"Studio Inxhinierie 59" sh.p.k.

Kreu 1

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja , Selia

Neni 1

Sot më datë 01.03. 2018, Unë Ing Shkëlqim Bumçi në bazë të legjislacionit Shqiptar për Shoqëritë Tregtare, dhe Aktit të Themelimit bashkangjitur këtij Statuti, themelova shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Studio Inxhinierie 59" sh.p.k Tiranë.

Neni 2

Shoqëria nga neni 1 I këtij statute krijohet me mjetet vetjake të "Ortakut të vetëm" Ing Shkëlqim Bumçi. Objekti I kësaj shoqërie sipas Aktit të Themelimit do të jetë : Mbikqyrja dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtim-Montimit, Oponencën e Projekteve si dhe Konulencën në përgjithësi.

Neni 3

Shoqëria nga neni 1 dhe 2 I këtij statuti do të ushtrojë veprimtarinë e saj me emërtimin "Studio Inxhinierie 59" sh.p.k.

Neni 4

Shoqëria ka statusin e personit juridik . Ajo ka vulën e saj. Vula ka formë të rrumbullakët rreth e përqark së cilës është shkruar Studio Inxhinierie 59 sh.p.k. në mes simboli I shoqërisë “SI59” ku me shkronja te vogla bashkangjiten fjalet Konsulence Oponence Mbikqyrje Kolaudim dhe poshtë fjalët Tiranë Shqipëri.

Qendra e shoqërisë është në Tiranë Rr e Kavajës Pallati Gora Nd 165, Ap , Njësia Administrative 7, 1001 Tiranë

Neni 5

Kohezgjatja Shoqërisë

Kohezgjatja e Shoqërisë është pa afat.

Neni 6

Kapitali

Kapitali Themeltar i shoqërisë Studio Inxhinierie 59 sh.p.k. do të jete 100.000 (nje qind mijë leke). Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem , e ndare ne 1 kuotë me vlerë 100.000 leke. Mjetet në të holla për krijimin e Shoqërisë dhe fillimin e punëve të saj i siguron “Ortaku i Vetëm” Ing Shkëlqim Bumci në përputhje me Aktin e Themelimit të Shoqërisë.



Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit

Kapitali mund të shtohet ose të pakesohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

Neni 8

Për detyrimet e veta të krijuara në qarkullimin juridik me persona të tretë Shoqëria përgjigjet me tërë pasurinë e saj. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e Ortakut të vetëm.

Neni 9

Organet Vendimmarrëse

Ortaku I vetëm I Shoqërisë është Organi I vetëm vendimmarrës I Shoqërisë.

Ai përcakton :

- a. Politikat tregtare të shoqërisë
- b. Ndryshimin e Statutit
- c. Emërimin dhe Shkarkimin e Administratorëve
- d. Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të miratuar.

Administratori i Shoqërisë do të jetë ortaku i vetëm Ing Shkëlqim Bumci

Neni 10

Viti Financiar

Viti Financiar I Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përbashimisht, viti I parë financiar fillon nga data e regjistrimit në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 11

Mardhëniet e punës në Shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe për çështjet që nuk rregullohen në kontratën e punës zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar të punës.

Neni 12

Riorganizimi I Shoqërisë Bashkimi-Ndarja

Shoqëria mund të ndahet sipas vendimit të Ortakut të Vetëm në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 dt 14.04.2012 :Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë Aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë Statut do të zbatohen dispozitat e ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrveshjet


Për Mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti si dhe për cdo mosmarrveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Për Shoqërinë

Studio Inxhinierie 59 sh.p.k.

Administratori

Ing Shkëlqim Bumçi


01.03.2018